

**ROBERT GJEDIA**

**REFORMIMI I ARSIMIT NËN DREJTIMIN E MINISTRIT  
MIRASH IVANAJ**

*Vitet 1933-1935 të shekullit të kaluar do të mbeten  
kohëra “të arta” për historinë e arsimit shqiptar.*

MIRASH IVANAJ

*Emri i Mirash Ivanajt është i lidhur ngushtë me faktin që sot shteti ynë ka një politikë arsimore “të pavarur”. Në shtypin e kohës<sup>1</sup> vlerësohej shumë personaliteti i Ivanajt. Në njërën prej gazetave të asaj kohe shkruhej: “Nuk veproi që të bëhej ministër, por u bë ministër që të vepronte”.*

Ishte koha kur arsimit përjetoi mbështetjen më të madhe dhe solli ndryshime esenciale, ligjore, përmbajtjesore, reformuese dhe ndikoi fuqishëm në jetën e shkollës, duke lënë gjurmë të përjetshme, të cilat kanë ndikimin e tyre dhe sot pas afro 90-të vitesh në arsimin shqiptar.

Mirash Ivanaj mund të konsiderohet një nga reformatorët e arsimit shqiptar gjatë periudhës së qeverisjes së Mbretit Zog. Ndonëse ky është qëndrim i ditëve të sotme dhe natyrisht ndikohet nga pikëpamjet, filozofitë, modelet që ekzistojnë sot për reformimin e arsimit, ky mendim tashmë është i konsoliduar dhe madje i pranuar nga të gjithë specialistët e fushës së arsimit.

Ivanaj studioi dhe u laureua me dy diploma universitare italiane. Ai ishte një njeri i lirë dhe me ide republikane. Në Shqipëri ai u kthye menjëherë pas diplomimit. Ndonëse pati ofertë pune edhe në Ministrinë e Jashtme Italiane, vijoi jetën dhe punën si mësues, drejtues gjimnazi, dhe më pas si ministër i Arsimit pranë Qeverisë së Mbretit Zog.

I motivuar për të reformuar arsimin shqiptar, si dhe duke marrë premtimin se nuk do t'i ndërhynte askush në punën e tij, ai bëri një

---

<sup>1</sup> Autori Nebil Cika në artikullin “Politika arsimore”, botuar në gazetën *Minerva*, nr. 23-24, shtator-tetor 1934.

analizë të thellë të gjendjes së arsimit në Shqipëri<sup>2/3</sup> si një nevojë e domosdoshme për të iniciuar dhe zhvilluar reforma afatgjata. Idetë e tij reformatore<sup>4</sup> u materializuan në këto iniciativa të guximshme për kohën:

1. Arsimi të ishte detyrim dhe përgjegjësi vetëm e shtetit.
2. Shtetëzimi i shkollave private dhe njëjësimi i arsimit kombëtar.
3. Ligjshmëri e plotë për arsimin.
4. Shkolla duhej të ushtronte veprimtari komplekse, pedagogjike, psikologjike e shoqërore. Në qendër të saj të ishte edukimi moral, patriotik e shoqëror.
5. Reformimi i përmbajtjes së shkollës fillore dhe asaj të mesme.
6. Botimi i teksteve shkollore.
7. Kujdesi shëndetësor.
8. Grumbullimi dhe hartimi i të dhënave statistikore të nxënësve.
9. Ridimensionimi i rolit të mësuesit, kualifikimi i tij.
10. Modelimi i shkollës përmes rregullave, përgjegjësive, disiplinës dhe funksionimit të pavarur të këshillit të mësuesve.
11. Kujdesi ndaj fëmijëve jetimë dhe të braktisur.
12. Përpjekjet kundër analfabetizmit.
13. Rritja e numrit të shkollave fillore.
14. Inspektimi i vazhdueshëm i mësuesve dhe shkollave.

▪ **Nevoja për shtetëzimin e shkollave private<sup>5</sup>, e cila u paraqit në një urdhër të posaçëm të Mbretit Zog**, u ideua nga Ivanaj, pasi ai me ekipin e tij analizoi situatën e krijuar. Ai arriti në përfundimin se ekzistenca e shkollave private mund të pengonte formimin e një brezi të shëndoshë, që ishte i domosdoshëm për afirmimin tonë si popull e si shtet. Kjo ishte e rëndësishme për popullin shqiptar dhe vendin tonë, pasi

<sup>2</sup> Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi (më tej: F.) 195 i Ministrisë së Arsimit, viti (më tej: V.) 1933, dosja (më tej: D.) 1, fl. 2, Material në shqip dhe frëngjisht për gjendjen e arsimit në Shqipëri përgatitur për Byronë Ndërkombëtare të Edukimit në Gjenevë.

<sup>3</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1933, D. 3, fl. 2, Shkresë me nr. 355 prot., dërguar Kryeministrisë, më datë 19 qershor 1933, nga arsimtarët e Durrësit, ku paraqitet situata e arsimit dhe mbështetja e idesë së shtetëzimit të Arsimit.

<sup>4</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1933, D. 287, fl. 1, nr. 2643, datë 04.06.1933, Përmbledhje e gazetës "Le Temps" mbi problemet e sistemit arsimor italian dhe politikat italiane mbi arsimin në Shqipëri.

<sup>5</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1934, D. 1, Ligja e re organike për arsimin dhe shtojcat e saj.

historia, dhe problemet që kishte krijuar pushtimi i gjatë shumëshekullor, kishin lënë mjaft boshllëqe e mangësi, të cilat lidheshin me disiplinën shtetërore, mungesa e së cilës lidhej ngushtësisht me ndërgjegjen dhe bashkimin kombëtar. Duke i konsideruar “një rrezik” shkollat e huaja, Ivanaj pohonte se, edhe sikur të huajt të vinin në Shqipëri me qëllime të vërteta mirëbërëse, nuk mund të kryenin misionin, për shkak se problemi i **edukimit moral patriotik e shoqëror** ishte shumë më i rëndësishëm se ai i rrafshit të njohurive. Sipas tij, ishte nevojë e domosdoshme të ndiqej një rrugë tjetër e njëlojtë për të gjithë nxënësit shqiptarë, larg ndryshimeve shoqërore, fetare e krahinore<sup>6</sup>. Ivanajt shtonte se, edhe sikur të bëheshin ligje për rregullimin dhe kontrollin e shkollave private (vendase ose të huaja), do të ishte punë tepër e vështirë që ato të zbatoheshin dhe të arrihej një përfundim i mirë.

*E para*, sepse ato shkolla demonstironin një autoritet të tillë që ishte e pamundur t’u nënshtroheshin ligjeve e rregullave zyrtare, por edhe kufizuese të kohës. Kjo do të sillte mosmarrëveshje, keqkuptime, të cilat ishin në dëm të edukimit të fëmijëve.

*E dyta*, analiza e situatës e bindi atë se, edhe sikur të hartoheshin ligje për mbikëqyrje të detajuara për këto shkolla, ato kërkonin shumë personel dhe shpenzime, gjëra të cilat shteti nuk mund t’i përballonte, apo nuk mund t’i bënte dot.

▪ **Sistemi arsimor** ishte krijuar gjatë dekadës së fundit dhe organizmi shkollor ishte zgjeruar në vitet 1920-1933. Ivanaj argumentonte se shkolla ende nuk ishte afirmuar si një **shkollë kombëtare**<sup>7</sup>. Ajo ishte një institucion i brishtë, i dobët dhe i pasigurt, ndaj ai kërkonte masa të thella, ndërhyrje dhe për përmirësimin themelor të saj. Shqetësimi më i madh për të ishte realizimi i projektit që shkolla të ishte gjithëshqiptare dhe, në radhë të parë e mbi çdo gjë, të edukonte atdhetarë në tërë komponentët e punës së saj, mësimore e jashtë-mësimore. Ivanaj deklaronte: “Në këtë mes, shteti nuk mund të hiqte dorë nga përgatitja totale, absolute, e tërë dhe e pandarë e qytetarëve të ardhshëm, duke mos u dhënë një shpirt, një mendim, një ndjesi, një të

<sup>6</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1931, D. 459, fl. 1, Shkresë e Ministrisë së Arsimit e datës 17.11.1931, dërguar Prefekturës Tiranë lidhur me kujdesin që duhet treguar për filmat që shfaqen në kinema, pasi cenojnë zakonet e respektuara në Shqipëri.

<sup>7</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 176, Projektregullore e shkollave të mesme.

*vetmin moral, pa ortakë e pa ndihmësa. Vetëm me këtë edukim shkollor mund të sigurohet e tashmja dhe të ndërtohet e ardhmja”*

Në rrafshin teorik dhe profesional, Ivanaj argumentoi se shkolla kishte të bënte me formimin e njeriut. Ajo ishte një **veprimtari mjaft komplekse pedagogjike, psikologjike e shoqërore** dhe, si e tillë, që të vihej me sukses në veprim, duhej që herë pas here të modifikohet për t’iu përgjigjur kërkesave të së ardhmes, në përputhje me shkallën e qytetërimit të popullit dhe me rrethanat politike, shoqërore e familjare. Nuk ishte e mundur, sipas tij, që në dy shtete, në dy popuj të zbatohet një sistem e një mënyrë shkollimi e edukimi. Prandaj Shqipërisë, e cila kishte një vend të veçantë në Evropë, i duhej edhe një institucion arsimor i veçantë, që t’i përshtatej gjithçkaje shqiptare. Këtë detyrë mund ta realizonte vetëm një shkollë mbarëshqiptare në përmbajtje dhe në metodë.

Në këto kushte, ai i kërkoi Parlamentit ndryshime ligjore, përkatësisht ndryshimin e neneve 206-207, të Statutit të Shtetit Shqiptar që lejonin hapjen e shkollave private.

*Argumentet dhe sugjerimet e Ivanajt i bindën autoritetet e kohës. Kështu më 11 prill 1933, Parlamenti miratoi njëzëri ndryshimet e statutit<sup>8</sup>, të cilat më 22 prill 1933 u sanksionuan dhe nga Mbreti. Më 26 prill 1933, ky vendim u zbatua me mbylljen e të gjitha shkollave private në Shqipëri.*

Nenet e statutit të shtetit shqiptar u ndryshuan si më poshtë:

**Neni 206:** Mësimi dhe edukimi i shtetasve shqiptarë, janë një e drejtë ekskluzive e shtetit. Jepen vetëm ndër shkolla shtetërore, shkollash të ndryshme, sipas ligjës.

Arsimi fillor, për të gjithë shtetasit shqiptarë asht i detyrueshëm dhe jepet falas.

Shkollat private, të çdo lloj kategorie qofshin që kanë veprue deri më sot, mbyllen.

**Neni 207:** Shkollat fetare për përgatitjen e klerit, të mbajtura prej komuniteteve fetare shqiptare, janë të lira dhe rregullohen me ligje.

Viti i ri shkollor 1933-1934 shënoi fillimin e njësimin të arsimit shqiptar, në të gjitha kategoritë e shkollave. Shkollat që u mbyllën në zbatim të reformës në arsim, ishin si më poshtë<sup>9</sup>:

<sup>8</sup> *Fletorja zyrtare*, Nr. 21 e vitit 1933, “Ndryshimi i neneve 197,206,207 të Statutit Themeltar të Mbretërisë” më datë 22.04.1933.

<sup>9</sup> Grup autorësh, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*” (pjesa e shkruar nga Iljaz Gogaj), Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë: 2003.

Nr.	Lloji i shkollës	Numri i tyre
1	Shkolla shqiptare private jofetare	21
2	Shkolla shqiptare klerikale myslimane	14
3	Shkolla shqiptare klerikale katolike	17
4	Shkolla shqiptare klerikale ortodokse	4
5	Shkolla të huaja për shqiptare	19
6	Shkolla private të minoritetit grek	10
	<b>Gjithsej</b>	<b>85 shkolla</b>

U suprimuan edhe këto shkolla të mesme të cilat u zëvendësuan me institucione të tjera arsimore.

Nr.	Shkolla të mesme të suprimuara
1	Shkolla Normale Femërore e Korçës
2	Instituti Privat Femëror “Naim Frashëri”
3	Instituti Privat Femëror “Kyrias”
4	Shkolla “Normale” Femërore Katolike e Stigmatinëve

- Në vend të këtyre shkollave u çelën shkolla të reja. Në shtator 1933 u themelua në kryeqytet Instituti Femëror “Nana Mbretneshë” me dy profile, *normale* dhe *gjimnaziale*.
- Në Korçë me ish-nxënës të shkollës *Normale Femërore*, u krijua një shkollë 4-vjeçare e quajtur qytetëse dhe në Shkodër, një degë e ulët femërore e Gjimnazit.
- U suprimua dega normale e shkollës teknike. Nxënësit e saj u shpërndanë në shkolla të tjera.
- Me largimin e personelit italian, shkollat profesionale italiane të Beratit, Gjirokastrës dhe Shkodrës, u mbyllën dhe në Berat, Korçë e Durrës u çelën shkolla qytetase 4-vjeçare, me program teorik e praktik, sipas nevojave rajonale.
- Shkolla teknike e Tiranës që u shtetëzua, u plotësua me personel të zgjedhur dhe u bënë ndryshime në strukturën dhe programin e saj.
- U suprimua gjimnazi ushtarak i Tiranës dhe shkolla bujqësore e Lushnjës. Nxënësit e tyre u shpërndanë nëpër gjimnaze të tjerë dhe në shkolla bujqësore.
- Reforma nuk preku Institutin shqiptaro-amerikan të Kavajës, sepse ai, në bashkëpunim me shtetin shqiptar, sipas një ligji të caktuar, i nënshtrohej kontrollit të shtetit dhe i jepte llogari atij.
- Nuk u cënua Liceu Kombëtar i Korçës, i cili edhe pse zhvillonte mësimet në gjuhë të huaj, kishte bashkëdrejtor shqiptar dhe, në pjesën

më të madhe, aty jepnin mësim mësues shqiptarë. Kështu, Ivanaj nuk e konsideroi shkollë të huaj.

Këto ndryshime ndikuan mjaft dhe bënë që shkolla shqiptare të hynte në një hap tjetër zhvillimi. *Është për t'u theksuar dhe për t'u vlerësuar si një ngjarje e veçantë në historinë e Shqipërisë, se viti mësimor 1933-1934 filloi tërësisht me shkolla shtetërore*<sup>10</sup>.

Kjo kthesë e menjëhershme krijoi dhe probleme, të cilat sollën jo pak qëndrime të ashpra, laiciste, sepse mjaft mësues me ndjenja laike nisën ta tepronin në mësimet e tyre me qëndrimet kritike ndaj klerit dhe fesë. Por ekipet e punës së Ivanajt, gjerësia dhe personaliteti i tij, si humanist, edhe pse ishte një ateist i deklaruar, nuk lejuan që të përgojohej feja në shkollë e, aq më tepër, të përbuzej. Ai ishte i bindur se nuk duheshin prekur ndjenjat fetare të popullit, pasi ato ishin një e drejtë civile e pamohueshme.<sup>11</sup>

▪ **Reforma e Ivanajt ishte tërësore dhe komplekse**<sup>12</sup>, sepse ajo preku të gjitha elementet e jetës së shkollës. Në qendër të reformës së iniciuar nga ai padyshim ishte mësuesi. Figura e mësuesit dhe roli i tij u konsideruan si një element kyç dhe si një faktor shumë vendimtar për mbarëvajtjen e punës së shkollës. Ai identifikoi, vlerësoi dhe e ngriti lart personalitetin e mësuesit<sup>13</sup>.

Mbështetja që ai dha për përmirësimin e sistemit të pagave të mësuesve, mundësoi që ky profesion të bëhej ndër më të respektuarit në shkallëzimin e hierarkisë intelektuale të vendit<sup>14</sup>. Ai e njihte mirë se

<sup>10</sup> AQSH, *Po aty*, F. 195, V. 1933, D. 333, Telegramë të ardhura nga mësues dhe shkolla të ndryshme ku e urojnë ministrin Ivanaj për shtetëzimin e shkollave; *po aty*, F. 195, V. 1933, D. 334, Falënderime të ministrit Ivanaj për orët pa pagesë të realizuara nga mësues dhe shkolla të ndryshme me rastin e shtetëzimit të shkollave.

<sup>11</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 290, fl. 1-3, Mbi Mësimin fetar, i cili nuk përfshihet në programin zyrtar dhe mund të jepet në gjuhën e minoritetit.

<sup>12</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1934, D. 1, Ligja e re organike për arsimin dhe shtojcat e saj; *po aty*, F. 195, V. 1933, D. 463, Projektligji për arsimin e mesëm; *po aty*, F. 195, V. 1934, D. 164, Programi mësimor i shkollave rurale; *po aty*, F. 195, V. 1935, D. 176, Projektregullore e shkollave të mesme; *po aty*, F. 195, V. 1935, D. 187, Për materialet didaktike dhe shkencore, Ministria e Arsimit, katalogu 195.

<sup>13</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 307, Projekt rregullore mbi emërimin e mësuesve dhe lutje për emërimet.

<sup>14</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1933, D. 45, Dekret për nxjerrjen në pension të arsimtarëve dhe nëpunësve të shtetit.

ç' ishte profesioni i mësuesisë, njihte kompetencat dhe aftësitë që kërkon ky profesion. Si rrjedhojë e kësaj mbështetje tek pjesa e shëndoshë e mësuesve u krijua besimit në vlerat e arsimit. Ishte një kohë kur askush nuk mund të nëpërkëmbte të drejtat e mësuesve, por nga ana tjetër, ishin të përcaktuara dhe të shkruara qartë në dokumentet zyrtare arsimore të kohës përgjegjësitë dhe të drejtat e mësuesve. Kjo krijoi një klimë profesionalizmi, sepse në atë kohë nuk mund të qëndronte ndokush në radhët e arsimtarëve, në qoftë se nuk e meritonte atë detyrë të rëndësishme.

Ivanaj ishte ministri i parë<sup>15</sup>, që u mor në mënyrë të drejtpërdrejtë me çështjen e pagave. Ai kërkoi nga Ministria e Financave, jo vetëm zgjidhjen e problematikave që ishin krijuar në këtë sistem, por edhe rritjen e pagave të mësuesve. Gjithashtu filloi edhe dhënia e pagesave të tjera suplementare për shërbime të veçanta që mësuesit kryenin në dobi të shkollës. Kjo nismë ishte një gur i parë themeltar në fushën e financimit të arsimit.

▪ **Kualifikimi i mësuesve** u mbështet nga qeveria dhe realizohej brenda afateve të përcaktuara në udhëzimet zyrtare, sipas kategorive të arsimtarëve<sup>16</sup>. Kjo dha rezultate në përmbushjen e kualifikimit sipas kategorive dhe brenda afateve.

Rigjenerimi i shkollave me mësues të kualifikuar u trajtua me përparësi nga ministri Ivanaj. Ai arriti të largojë, nga mjaft shkolla, mësues të paaftë, me vese, me sjellje dhe me personalitet të papërshtatshëm për këtë profesion. Jo vetëm që u larguan mësues që nuk mund të përballonin reformën e filluar, por u morën masa shumë të shpejta dhe për nxjerrjen në pension të shumë mësuesve, që ishin në prag të tij. Në periudhën prill-shtator 1933 u bë numri më i madh i lëvizjes së kuadrit, gjatë periudhës 15-vjeçare, 1925-1939.

U larguan nga arsimit 41 mësues të paaftë dhe me sjellje jokorrekte në punë<sup>17</sup>. U transferuan 200 të tjerë, nga të cilët disa u transferuan edhe me kërkesën e tyre. Vendet e lira të punës u zëvendësuan me të rinj që kishin shkolla të mesme. Si kriter kryesor ishte aftësia e tyre. Kështu në rastin e

<sup>15</sup> *Fletorja zyrtare*, nr.9, datë 11.03.1993, "Ligje mbi bartje fondesh në buxhetin e ushtrimit financiar tek Ministria e Arsimit". Dekretuar me datë 09.03.1933.

<sup>16</sup> *AQSH*, F. 195, Regjistri i rrogave të personelit arsimor, viti 1931-1932, D. 397, fl. 1-4, Ligji i kategorizimit dekretuar në vitin 1925 dhe plotësuar me "shtojca" në vitin 1930.

<sup>17</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1934, D. 374, Lista e mësuesve të mbetur jashtë kuadrit mësimit.

një emërimi në qytetin e Korçës, kandidatë ishin katër veta për një vend pune dhe kishin arritur rezultate të njëjta në maturë. Në këtë rast, Ministri emëroi atë që kishte notat më të mira gjatë gjithë viteve të shkollës së mesme. Zbatimi me rigorozitet i kriterëve të shpallura bëri të mundur që të mos kishte asnjë ankesë në këtë drejtim gjatë viteve të punës së Ivanajt si ministër.

Ministri Ivanaj bëri shumë kujdes për të vënë në vendin e duhur personalitetin e mësuesit. Ai dhe stafi i tij u tregua mjaft i rreptë ndaj<sup>18</sup>:

- lejeve të tepërta dhe raporteve mjekësore jokorrekte të mësuesve;
- pastërtisë vetjake, rregullit dhe përdorimit të uniformës nga mësuesit në mjediset e shkollës. Mësuesit e Korçës ishin të parët që përqaftuan veshjen dhe përdorimin e uniformës me grykëse dhe jakë të bardhë;
- përdorimit të uniformës së nxënësve të shkollave të mesme me siglën dalluese për secilën shkollë më vete;
- largimit nga mjediset e shkollave të shitësve të ndryshëm, (sheqerxhinjtë dhe hallvaxhinjtë) duke argumentuar se një situatë e tillë krijonte probleme të higjienës, ishte burim i prodhimeve të pakontrolluara, por dhe një problem social, pasi kishte mjaft fëmijë që nuk mund të blinin gjësendi;
- shpalljen e kuadrit mësimor që në fillim të vitit shkollor, gjë që nuk ishte bërë asnjëherë më parë.

Ndërhyrjet e ministrit Ivanaj synonin disiplinimin dhe rritjen e cilësisë së punës së mësuesit, ndaj ato nuk sollën asnjë pakënaqësi e shkrehje të punës, por, përkundrazi, sollën motivim dhe entuziazëm që nuk ishte vërejtur në të kaluarën<sup>19</sup>. Kështu mësuesit e gjimnazit të Shkodrës i falën shtetit për një vit shtesën 4-vjetore, të vjetërsisë në punë, madje diku falën edhe rroga mujore<sup>20</sup>. Në disa qytete shumë intelektualë kërkuan të jepnin vullnetarisht orë mësimi në shkolla.

▪ **Vëmendje e madhe iu kushtua disiplinës, si baza dhe themeli i punës.** Ministri Ivanaj lëshoi një sërë qarkoresh dhe udhëzimesh, për t'i prerë udhën dhe për të ndaluar të gjitha aktet antidisiplinore në shkolla.

<sup>18</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 176, Projektregullore e shkollave të mesme.

<sup>19</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 175, Projektregullore për detyrat e drejtuesve të shkollës së mesme.

<sup>20</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1933, D. 334, Falënderime Ministrit Ivanaj për orët pa pagesë të realizuara nga mësues dhe shkolla të ndryshme me rastin e shtetëzimit të shkollave.

Ishte e kuptueshme që vetëm me masa administrative, aq më tepër me masa të forta, nuk mund të sigurohej disiplina e qëndrueshme dhe e vetëdijshme. Por, megjithatë fillimisht këto masa sollën rezultate pozitive. Ivanaj nuk punonte “ex cathedra”, nga pozitat e akademizmit pedagogjik, por nga pozitat e një mësuesi shqiptar, i cili gjendej vërtet në mes të Evropës gjeografikisht, por ishte ende larg kulturës evropiane. Në një rast ai pohonte: *“Kur faji bën ‘mu’ në mesin e nxënësve të shkollës së mesme, atëherë arsyetimet e gjata dhe argumentimet e tepërta, i bëjnë hije zbutëse dhe dobësuese vendimit të marrë nga shkolla, e cila në këtë rast ‘rrihte ujë në havan’ ose qëndronte ‘në vend numëro’*”.

Kërkesat rigorozë dhe masat e ndëshkimit të përdorua nga Ivanaj nuk ishin dhunë ndaj personalitetit të nxënësit. Si një ish-mësues, si një ish-drejtor dhe tashmë si ministër, Ivanaj jo vetëm nuk i njohu mjetet e dhunës, por përkundrazi i dënoi ato. Ai ishte dhe u deklarua kategorikisht kundër dhunës fizike, rrahjes së nxënësve<sup>21</sup>, dhunës psikologjike, fyerjes së nxënësve me fjalë fyese dhe antipedagogjike. Në prill të vitit 1934, ai vërente me keqardhje se disa mësues silleshin në mënyrë të pahijshme kundrejt nxënësve, herë duke i rrahur e herë duke përdorur fjalë të palejueshme. *“Këto mjete, vuri në dukje ai, jo vetëm kujtojnë një kohë mentalitetesh të kapërcyeme, kur mbytej personaliteti i nxënësit, por nuk kanë asnjë dobi edukative dhe nuk janë të njerëzishme”*. Për këto arsye, ai kërkoi që të merreshin masa të rënda ndëshkimore për ata mësues, të cilët vepronin në kundërshtim me rregullat.

Tashmë ishin parashikuar dhe llojet e dënimeve për nxënësit, duke rritur nivelin e disiplinës pedagogjike në shkolla dhe duke u mbyllur rrugën veprimeve arbitrare, antihumane e antiedukative.

Në një qarkore të vitit 1933, Ivanaj bëri thirrje që *djalëria shqiptare*, të rritej mendërisht, moralisht e trupërisht vetëm me *“një atmosferë discipline ndëgjese, njerëzie e burrënie”*, për të rritur në shkollë burra trima, që të përballonin vështirësitë e jetës e të mos ishin frikacakë.

▪ **Rritja e autoritetit të mësuesit, në mënyrë të posaçme e drejtorit të shkollës dhe këshillit pedagogjik, të cilit i shtoi kompetenca vendimmarrëse, janë tregues të mbështetjes së autonomisë shkollore.** Për më tepër, Ivanaj, si ministër i Arsimit, nuk

<sup>21</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 176, Projektregullore e shkollave të mesme.

ndërhyri kurrë në punët e këshillave pedagogjike dhe nuk kundërshtoi asnjëherë vendimet e tyre.

▪ **Edukimi i të rinjve përmes veprimtarive jashtëshkollore** u mbështet shumë nga ministri Ivanaj, i cili shquhej për një largpamësi dhe vizion të kthjellët. Ai këmbëngulte se edukimi i rinisë nuk duhet të mbetet vetëm brenda mureve të shkollës. Ivanaj bëri përpjekje për krijimin e fushave të veprimit të nxënësve në bregdet dhe në zonat malore. Për këtë ai hartoi me dorën e vet rregulloren përkatëse. Vështirësitë e mëdha ekonomike të kohës nuk mundësuan vënien në jetë të këtij projekti.

Përveç rinisë shkollore, Ivanaj si shtetar me botëkuptim të përparuar në të mirën e përgjithshme të brezave e të kombit, synonte të angazhonte të gjithë rininë qytetare të vendit në një shoqatë sportive e kulturore kombëtare. Me nismën e drejtpërdrejtë të tij, gjatë vitit shkollor 1934-1935, u themeluan në prefektura dhe nënprefektura 21 organizata jashtëshkollore për rininë, në degë të ndryshme sportive, artistike e kulturore. Këto ishin “21 qendra të shqiptarizimit, - siç i quajti ai, - me më shumë se 2000 anëtarë vullnetarë, këta të një fushe jo më pak fisnike, si ajo e mbrojtjes së limereve të kufirit”. Në fjalimin e pëdurimit, më 18 gusht 1935, Ivanaj tërhoqi vëmendjen, në radhë të parë, për rolin e shoqatave në forcimin e kolektivitetit kombëtar. Kur Ivanaj nuk ishte më ministër, doli edhe organi i shoqatës, “Sporti Shqiptar”. Për të vënë në jetë këto detyra nën drejtimin dhe udhëheqjen e Ministrisë së Arsimit, Enti Kombëtar “Djelmënia shqiptare” u fut tashmë në strukturën e dikasterit, si seksion i tij i veçantë<sup>22</sup>. Në buxhetin e atij seksioni, parashikohej edhe ngritja e stadiumit kombëtar në Tiranë.

Shtimi i numrit të shkollave ishte një prioritet i punës së Ivanajt. Ishte koha kur kriza ekonomike në Shqipëri ishte në kulmin e saj. Ai, jo vetëm që diti ta përdorë me shumë efikasitet buxhetin ekzistues të dikasterit të tij, por, falë përpjekjeve të forta në Parlament, arriti ta shtojë atë buxhet, duke arritur t’i marrë buxhetit të përgjithshëm të shtetit, për vitin 1934, 1/5 e shumës së tij të përgjithshme. Këto përpjekje dhanë rezultate

<sup>22</sup> Fletorja zyrtare nr. 26, datë 15.05.1935. Dekretligj mbi kthimin e Entit Kombëtar “Djelmënia Shqiptare” në Seksion të Ministrisë së Arsimit” dekretuar më 25.04.1935

pozitive. Në fund të vitit shkollor 1933-1934, Shqipëria kishte 62 shkolla fillore më shumë se një vit më parë<sup>23</sup>.

Në shërbim të shtimit të mëtejshëm të shkollave në të ardhmen, Ministri u kujdes posaçërisht për shkollën *Normale* të Elbasanit, në radhë të parë për shtimin e kapacitetit të saj. Ai i dha shtysë punimeve për ndërtesën e re të shkollës dhe shtoi kapacitetin e konviktit, duke marrë me qira konakët e Dervish Biçakçiu në Elbasan.

Për të futur në udhë të mbarë e të sigurt çështjen e zgjerimit të rrjetit shkollor, veçanërisht në fshatra, pas një debati në Këshillin e Ministrave, qeveria vendosi të krijoheshin komisione të posaçme në prefektura për të përcaktuar vendet ku duhej të ngriheshin shkollat e reja. Sipas udhëzimeve me shkrim të Ministrit Ivanaj, komisionet do të përcaktonin ngritjen e shkollave sipas kriterit, nëse shkolla ishte e domosdoshme, e nevojshme, apo e dëshirueshme.

▪ **Në bazë të ligjit që sanksionoi Reformën arsimore, për herë të parë shteti shqiptar përfshiu në buxhet edhe shpenzime për shkollimin shqip të fëmijëve të diasporës shqiptare.** Në të njëjtën kohë, Ivanaj vuri mori masa për të zgjidhur edhe çështjen e pajisjes së shkollave me orendi dhe mjete mësimore, duke u përpjekur maksimalisht që edhe buxheti i vogël bashkiak të shfrytëzohej sa më përpjesëtimisht. Kjo bëri të mundur që, në mjaft qarqe të vendit, si në Korçë, Elbasan, Lushnjë, etj., pati nisma për të ngritur shkolla të reja, si dhe mjaft përpjekje të suksesshme për pajisjen më të mirë të shkollave ekzistuese.

▪ **Botimi i teksteve shkollore,** që kishte qenë një problem i mprehtë i pazgjidhur në shkollat shqiptare, u trajtua me përparësi nga Ministri Ivanaj. Në këtë kohë u mundësua që:

- të ribotohen disa tekste mësimore, të cilat ishin bërë të rralla në atë kohë;
- të krijohen komisione të posaçme për rishqyrtimin e disa librave të tjerë shkollorë, që kishin mbetur në dorëshkrim;
- t'u bëhej një kritikë e rreptë disa teksteve, si nga ana e përmbajtjes, ashtu edhe nga ana gjuhësore;

---

<sup>23</sup> *AQSH, Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 18, Korrespondenca, pasqyra dhe përmbledhje të statistikave të arsimit për vitin mësimor 1933-1934.

- u botuan për herë të parë me shaptilograf disa tekste mësimore nga vetë shkollat e mesme.

▪ **Bursat e studimit**<sup>24</sup>. Në procesin e dhënies së bursave ishin krijuar probleme serioze dhe një shqetësim i madh për padrejtësitë dhe abuzimet në dhënien e tyre. Ministri Ivanaj ndërhyri me forcë për të vendosur kritere të shëndosha dhe për t'i zbatuar ato. Kjo ishte një pjesë e rëndësishme në reformën e tij.

Meqenëse zëri i bursave në buxhetin e Ministrisë së Arsimit ishte shumë i ngarkuar, me guxim që e karakterizonte, ai e përgjysmoi atë. Gjysmën e atyre të ardhurave e shfrytëzoi për rrogat e mësuesve, për shtimin e numrit të shkollave dhe për pajisjen materiale të tyre. Natyrshëm shkurtimi solli edhe pakësimin e bursistëve. U shkurtuan 700 bursa për studentë jashtë shtetit dhe për nxënës brenda vendit. Për herë të parë u fut me të vërtetë konkurrimi për ndarjen e bursave. Nga kontingjentet e bursave të brendshme, ai caktoi mbi 60% të tyre për shkollat profesionale. Përparësi kishin shkollat pedagogjike, pasi i jepnin vendit më shumë mësues. Kjo ishte edhe një masë demokratike në rrafshin shoqëror, sepse shkollat profesionale, në përgjithësi, ishin të preferuara për shtresat shoqërore me mundësi të kufizuara ekonomike.

Masë e rëndësishme që mund t'i vinte fre abuzimeve në ndarjen e bursave, ishte përqendrimi i tërë bursave të studimit që jepte shteti, vetëm në Ministrinë e Arsimit. Në këtë mënyrë, Ivanaj bëri edhe një ndarje racionale të kontingjentit të bursave, që shkollimi i lartë dhe i mesëm, t'i shërbente sa më shumë nevojave më aktuale të zhvillimit të vendit.

Përparimin e bursistëve, sidomos atyre që studionin jashtë shtetit, Ivanaj e ndoqi me vëmendje të veçantë, duke kërkuar raportime të rregullta për përparimin dhe jetesën e tyre.

Duhet theksuar se reforma e iniciuar nga ministri Ivanaj nuk la element profesional pa prekur në jetën e shkollës. Ndër çështjet e tjera të rëndësishme që ajo preku ishin:

- *Krijimi i statistikave dhe informacionet peridike që shkollat i dërgonin Ministrisë së Arsimit dhe anasjelltas*<sup>25</sup>. Në bazë të kërkesave

<sup>24</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 295, fl. 1, Lista e ligjeve dhe rregulloreve të dekretuara dhe të miratuara gjatë mandatit të ministrit M. Ivanaj.

<sup>25</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1928, D. 85, Raporti i Byrosë Ndërkombëtare të Arsimit në Gjenevë, Dokumenti A 31-1928. Rregulla të njëjta për statistikat e arsimit të miratuara

dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit siguronin të dhëna për numrin e fëmijëve të regjistruar në shkolla, numrin e nxënësve sipas gjinisë, dhe raportet e nxënësve fshat-qytet. Sipas dekretligjit të vitit 1934, në prefektura, nënprefektura e komuna krijoheshin komisionet shkollore që ndiqnin edhe vijimin e shkollës. Ivanaj ishte i vetmi Ministër që zbatoi formate statistikash të sakta, sipas rregullave të Byrosë Ndërkombëtare të Edukimit, të përcaktuara në Kongresin e Kajros që në vitin 1928.

- *U mbështetën zhvillimet e kurseve kundër analfabetizmit, të cilat ndonëse ishin hapur edhe më parë në disa zona, vetëm pas shkurtit 1933 nisën të gjallërohen. Ministri Ivanaj u bëri thirrje arsimtarëve që, sipas mundësive, të jepnin mësim vullnetarisht në ato kurse, katër ditë në javë, nga dy orë në ditë. Vetëm për analfabetët, qytetarë të rritur dhe për analfabetët e burgosur, ai kërkoi që të jepeshin mësim falas. Autoriteti i tij bëri që kurset të jepnin shpejt përfundime shumë të mira. Në dhjetor 1933, duke marrë shkas nga mësuesit e Elbasanit<sup>26</sup> ai iu drejtua arsimtarëve të të gjithë vendit me një qarkore të posaçme në të cilën thuhej: “Po konstatoj me mburrje, - thuhej aty,- se arsimtarët tanë po e zgjerojnë misionin e tyre si e do e mira e atdheut dhe po bahen mjekët e shoqërisë kombëtare, me luftue një nga plagët ma të rrezikshme të saj analfabetizmin. Të shpëtojmë popullin tonë të dashur, atë që nuk i kursen atdheut djersën dhe gjakun e vet, nga thonjtë e këtij armiku të rrezikshëm, si është analfabetizma. Ky është sa një ideal i bukur kombëtar, një lakmi e lavdishme dhe e shenjtë për çdo shqiptar, për çdo edukator dhe për shtetin tonë”.*

Kurset u gjallëruan gjithandej në qendrat kryesore të vendit, si: Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Tiranë etj. Ministri, gjithnjë i ndjeshëm ndaj nismave të reja, iu shkruante, ndër të tjera, arsimtarëve të Gjirokastrës, në mars 1934: “*Tre kurset për analfabetë që janë çelë, numri i konsiderueshëm i ndjekësve, kursi për vajza analfabete që filloj punën, dëshira që po tregojnë mësuesit për formimin e një kori, konferencat që mbahen, përmbajnë fakte të gjallë dhe janë një dëshmi se në atë qytet, po bahet diçka me rëndësi jo të paktë, jo vetëm për kulturën e popullit, por edhe për drejtimin e dobishëm që po merr jeta e arsimtarëve.*”

në Kongresin e Kajros më 1928. Broshurë me 30 faqe në frëngjisht. Ky raport i është dërguar më 1 nëntor 1928 me Nr. 2415 Prot, e Ministrisë së Arsimit në Tiranë.

<sup>26</sup> Revista *Normalisti*, qershor 1933, Java e dytë.

- *Shërbimi mjekësor në shkollë nisi për herë të parë në historinë e shkollës shqiptare me reformën Ivanaj*<sup>27</sup>. Ky shërbim në shkolla u fut në vitin 1933. Kjo reformë tregoi kujdes për shëndetin e nxënësve në shkolla. Sigurisht që kjo çështje kishte lidhje me shumë tregues e faktorë të mirërritjes së gjithanshme në familje e në shoqëri, por aq sa munda, ai u përpoq që të paktën në shkollë, të vihej nën një farë kontrolli gjendja shëndetësore e nxënësve dhe, në raste specifike, të merreshin masa të mundshme parandalimi ose kurimi për sëmundjet epidemike.

Ministri Ivanaj më 4 maj 1933 i kërkoi Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë për krijimin e politikave shkollore, por me 31 tetor të atij viti mori një përgjigje negative. Megjithatë brenda atij viti u siguroi në qytetin e Tiranës shërbimi poliklinik për nxënësit e shkollave, pranë spitalit të përgjithshëm civil. Sipas urdhrit të prerë të ministrit, do të kontrolloheshin të gjithë nxënësit, para se të futeshin në klasën e parë të shkollës fillore.

Në janar të vitit 1934, Ministria e Arsimit u dërgoi një qarkore me përmbajtje të rreptë<sup>28</sup>, gjithë shkollave që të tregonin kujdes për pastërtinë trupore të nxënësve. Aty parashikoheshin edhe masa ndëshkimore ndaj nxënësve ose prindërve.

Nga pamundësia për të mbikëqyrur gjendjen shëndetësore të nxënësve me anë të mjekëve, me kërkesën e Ministrit të Arsimit, në gusht 1934, Drejtoria e Përgjithshme e Shëndetësisë hapi dhe zhvilloi në Tiranë kurse disaditore për mësuesit e shkollave fillore që të përvetësonin norma për kontrollin higjienik të nxënësve.

*Reforma u sintetizua në Dekretligjin Organik të Arsimit që u dekretua nga Mbreti Zog më 26 shtator 1934. Ai kishte 448, nene të ndara në 7 pjesë dhe çdo pjesë ndahej në kapituj, tituj, dispozita e nene. Ky ligj që sanksionoi këtë reformë cilësore për herë të parë në arsimin shqiptar, u prit shumë mirë në prefekturat dhe qendrat administrative të vendit. “Në rrjedhën e arsimit kombëtar, shkruante ato ditë gazeta “Besa” e kryeqytetit, java e dytë e prillit është për tu kujtuar si një javë e shenjtë arsimore dhe prej arsimtarëve tanë është për t’u festuar vit për vit, për të*

<sup>27</sup> *AQSH, Po aty*, F. 195, V. 1933, D. 246, Shkresë e ministrit Ivanaj më 4.5.1933 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shëndetësisë një shkresë për krijimin e politikave shkollore që kanë të bëjnë me shëndetin.

<sup>28</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 295, fl. 1, Lista e ligjeve dhe rregulloreve të dekretuara dhe të miratuara gjatë mandatit të ministrit M. Ivanaj.

bërë të paharruar veprën e lartë kombëtare, që u realizua brenda kësaj jave”.

Reforma tërësore e ministrit Ivanaj u cilësua nga intelektualët e kohës si një vepër origjinale shqiptare, e mbështetur në përvoja evropiane.

### **Kundërshtarët e reformës “Ivanaj”**

Reforma arsimore e iniciuar dhe e zbatuar nga Ivanaj pati dhe kundërshtarët e saj që ishin:

1. Përfaqësues të besimeve fetare në Shqipëri, të cilët kundërshtuan mbylljen e shkollave fetare<sup>29</sup>. Këta përfaqësoheshin nga kleri katolik, kleri mysliman dhe ai ortodoks.

2. Përfaqësues të minoritetit grek në Gjirokastrë, të cilët ishin kundër mbylljes së shkollave private greke.

3. Autoritetet shtetërore greke, të cilat ishin në një linjë me klerin ortodoks.

4. Qeveria italiane e cila, në të vërtetë, nuk doli haptazi, por në shumë dokumente diplomatike të kohës gjejmë të qartë qëndrimin kundërshtues të saj për mbylljen e shkollave të huaja.

Kundërshtarët e kësaj reforme përdorën mjaft rrugë dhe mjete propagandistike, si në rastin e klerit katolik, mysliman dhe ortodoks, i cili përdori dhe argumente historike lidhur me kontributin që kanë dhënë klerikët e të tria besimeve për zhvillimin e arsimit shqiptar. Këto kundërshti u shoqëruan dhe me trazira të organizuara nga kleri katolik në qytetin e Shkodrës, ku pati edhe grindje mes nxënësve të besimeve të ndryshme, por edhe me një protestë të organizuar nga kleri ortodoks në qytetin e Gjirokastrës.

Autoritetet shtetërore greke e konsideruan mbylljen e shkollave private greke si një ndëshkim dhe parandalim të mësimin të gjuhës greke. Shteti grek, me anë të konsullatave të tij në Shqipëri, organizoi një fushatë shpifëse dhe propagandistike kundër shtetit shqiptar. Si autoritetet shtetërore greke, ashtu edhe ato italiane shfrytëzuan njohjet e tyre në aspektin ndërkombëtar dhe u përpoqën rreth dy vjet duke e shëndërruar këtë çështje në një problem me karakter ndërkombëtar. Ata i drejtuan ankesa zyrtare Lidhjes së Kombeve në Gjenevë.

<sup>29</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1932, D. 71, Mbi mësimin e fesë në shkolla; Kuvendi jezuit në Shkodër, - Shqypnia e ilustrueme, Shkodër, shtypshkronja “Zoja e papërlyeme”.

Pas shqyrtimit fillestar, Lidhja e Kombeve nuk konstatoi ndonjë shkelje të drejtave të minoritetit grek dhe interesave të shkollave italiane. Rezultoi se shkollat profesionale italiane nuk ishin mbyllur sipas ligjit, por këto shkolla do të varehin tani e tutje nga një seksion i Ministrisë së Arsimit. Ligji përcaktonte që, krahas drejtorit teknik italian, do të kishte dhe një drejtor administrativ shqiptar. Kjo kishte shqetësuar shtetin italian, i cili i largoi menjëherë stafet e mësuesve të tyre, duke marrë me vete të gjitha pajisjet e instaluar në shkolla. Nga ana tjetër, kjo reformë u siguronte minoriteteve të drejta të njëjta si për shtetasit shqiptarë. Mbyllja e shkollave private nuk ishte kundërshti ndaj pakicës greke në Shqipëri, që të hiqte dorë nga ajo që formon thelbin e jetës së saj si etni më vete. Pas këtij qëndrimi të Lidhjes së Kombeve, shteti italian dhe ai grek, duke e trajtuar këtë problem si një çështje juridike, iu drejtuan Gjyqit Ndërkombëtar të Hagës, i cili mbështeti kërkesat e shtetit grek dhe atij italian me 8 vota pro dhe 3 kundër. Në mbrojtje të reformës shqiptare, nga kjo gjykatë, ishin kryetari i saj anglezi, *Sër Hurt*, si dhe anëtarët: *rumuni Negulesko dhe polaku Rost Vorovski*.

Qeveria shqiptare iu nënshtroi vendimit të Gjyqit Ndërkombëtar dhe shkollat private minoritare greke u rihapën. Në këto rrethana ministri Ivanaj dha dorëheqjen më 16 gusht 1935, vetëm pas dy vitesh e gjysmë pune. Në momentin e kësaj dorëheqjeje ai deklaroi<sup>30</sup>: *“Vetëm në shkollat e shtetit, pa as më të voglin cënim të të drejtave individuale ose kolektive, djelmënia jonë mund të edukohet si e tillë e të fitojë ndjesinë e ndërgjegjen kombëtare, moralin dhe disiplinën shtetërore. Në kuptimin e sakrificës për atdheun e për Mbretin, nuk mund të bashkohem me mendimin e shumicës së Këshillit Ministror e të pranoj çfarëdo ndryshimi në zbatimin e nenit 207 të Statutit të Mbretnisë”*.

Ky akt dorëheqjeje u prit me dhimbje, por dhe u vlerësua lart nga intelektualë të ndryshëm nga i gjithë vendi.

---

<sup>30</sup> *Po aty*, F. 195, V. 1935, D. 295, fl. 1, Lista e ligjeve dhe rregulloreve të dekretuara dhe të miratuara gjatë mandatit të ministrit M. Ivanaj.